



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2023

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: “PISHA” sh.p.k me adresë: Rruga Labinot fushe Elbasan km 1, zk 2355, pasuria nr.A.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-83627-10-13-2023**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Investime ne fondin pyjor”, me fond limit: **10.829.896** (dhjetëmilion e tetëqind e njëzet e nëntëmijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan, dhe me afat për kryerjen e shërbimit **3 vjet**:

Pyllëzimi do të bëhet në periudhen Nentor – Mars në vitin e parë.

Zëvendesimi do të bëhet në periudhen Nentor – Mars pas 1 viti nga mbjellja.

Shërbimet do të bëhen në periudhen Qershor – Korrik për çdo vit.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE: “LURIMI” sh.p.k me Nipt: J68403912U dhe DEMA CONSTRUCTION 2014 sh.p.k me Nipt: L41714507K

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **8.203.413** (tetëmilion e dyqind e tremijë katërqind e trembëdhjetë) **lekë (pa tvsh)**.

2. “PISHA” sh.p.k me Nipt: K12526207V

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **10.440.442** (dhjetëmilion e katërqind e dyzetmijë e katërqind e dyzet e dy) **lekë (pa tvsh)**.

3. “KURORA” sh.p.k me Nipt: J76314803S

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **8.897.978,63** (tetëmilion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë presje gjashtëdhjetë e tre) **lekë (pa tvsh)**.

Ofertues të s’kualifikuar ka, operatorët ekonomik BOE: “LURIMI” sh.p.k me Nipt: J68403912U dhe DEMA CONSTRUCTION 2014 sh.p.k me Nipt: L41714507K dhe “KURORA” sh.p.k me Nipt J76314803S për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomiK BOE: “LURIMI” sh.p.k me Nipt: J68403912U dhe DEMA CONSTRUCTION 2014 sh.p.k me Nipt: L41714507K skualifikohet për arsyet e mëposhtme:

1. Në shtojcën 9 të DST (Formulari përmbledhës i vetdeklarimit), Pjesa e II: Shkaqet e përjashtimit, Seksioni A: DEKLARATË, Për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, operatori ekonomik “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k, NIPT: L41714507K, të ngarkuar në sistemin elektronik të APP-së, lidhur me këtë procedurë prokurimi deklaroi se ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv. Por nga verifikimi në QKB i Ekstraktit Historik i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit „Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar“ të subjektit sipërcituar, rezultoi se operatori ekonomik “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k, në Objektin e aktivitetit (pika 9) nuk ka të përfshirë, zbatimin e aktiviteteve në fushën e pyjeve dhe kullotave. Për pasojë, ky informacion konsiderohet i pasaktë (i rremë), i deklaruar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “LURIMI“ sh.p.k & “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k, për pasojë plotëson kriteret e prashikuara të ligjit 162/2020 „Për Prokurimin Publik“, Neni 76, pika 3.ë dhe 5, “Kriteret detyruese për skualifikim“. 2. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistem elektronik të APP-së, lidhur me këtë procedurë prokurimi, nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “LURIMI“ sh.p.k & “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k, Operatori Ekonomik “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k nuk disponon çertifikatën SSH/EN-ISO 9001-2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë“. Ky dokument, pamvarësisht % që merr

përsipsër të realizojë çdo operator ekonomik në një bashkim operatorësh ekonomik, është certifikatë që ka lidhje me menaxhimin e cilësisë së punës dhe nuk ka të bëjë me elementë të veçantë të një operacioni apo produkti në realizimin e këtij shërbimi. Ky operator ekonomik sipas kontratës për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, të datës 31.10.2023 me operatorin ekonomik tjetër “LURIMI” sh.p.k, merr përsipër të realizojë 35 % të punimeve. Sa më sipër ky operator ofertues nuk plotëson pikën 2.3.5 (Kapaciteti teknik) të DST. Sa më sipër Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “LURIMI“ sh.p.k & “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k, nuk përmbush kërkesat për kualifikim dhe pikërisht kërkesat e specifikuara në Nenin 88, pika 3, të VKM-së nr. 285 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. 3. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistem elektronik të APP-së, lidhur me këtë procedurë prokurimi, nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “LURIMI“ sh.p.k & “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k, Operatori Ekonomik “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k nuk dokumenton dhe vërteton se ka realizuar me sukses kontrata për shërbime të mëparshme, të ngjashme. Ky operator ekonomik sipas kontratës për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, të datës 31.10.2023 me operatorin ekonomik tjetër “LURIMI” sh.p.k, merr përsipër të realizojë 35 % të punimeve (punime të cilat sipas natyrës së bashkpunimit, janë punime drejtëpërsëdrejti në terren të karakterit pyllëzime, zëvendësime dhe shërbime kulturale). Bazuar në argumentat e parashtruara më lart, Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “LURIMI“ sh.p.k & “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k, nuk përmbush kërkesën 2.3.1 të DST (Kapacitetin teknik) për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, në raport më %, që operatori ekonomik “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k, ka marrë përsipër të realizojë në kontratën për bashkimin e përkohshëm të shoqërive (35 %), të datës 31.10.2023, të ngarkuar në systemin elektronik të APP-së, lidhur me këtë procedurë prokurimi. 4. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistem elektronik të APP-së, lidhur me këtë procedurë prokurimi, nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “LURIMI“ sh.p.k & “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k, Operatori Ekonomik “LURIMI“ sh.p.k, deklaron (shtojca 9; formulari përmbledhës i vetdeklarimit) dhe dokumenton (listpagesat e 3 muajve të fundit), që disponon mesatarisht 7 (shtatë) punonjës/në muaj. Ky operator ekonomik sipas kontratës për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, të datës 31.10.2023 me operatorin ekonomik tjetër “DEMA CONSTRUCTION 2014” sh.p.k, merr përsipër të realizojë 65 % të punimeve. Bazuar në këtë % dhe numrit prej 17 punonjësiash të përcaktuar në DST, pika 2.3.7, operatori ekonomik “LURIMI”sh.p.k, duhet të dispononte 11 (njëmbëdhjet) punonjës. Sa më sipër Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “LURIMI“ sh.p.k & “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k, nuk plotëson pikën 2.3.5 (Kapaciteti teknik) të DST si dhe nuk përmbush kërkesat për kualifikim dhe pikërisht kërkesat e specifikuara në Nenin 88, pika 3, të VKM-së nr. 285 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. 5. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistem elektronik të APP-së, lidhur me këtë procedurë prokurimi, nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “LURIMI“ sh.p.k & “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k, Operatori Ekonomik “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k, deklaron (shtojca 9; formulari përmbledhës i vetdeklarimit) dhe dokumenton (listpagesat e 3 muajve të fundit) se nuk disponon drejtuesin teknik, i cili duhet të jëtë

inxhinier pyjesh.. Ky operator ekonomik sipas kontratës për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, të datës 31.10.2023 me operatorin ekonomik tjetër “LURIMI” sh.p.k, merr përsipër të realizojë 35 % të punimeve (punime të cilat sipas natyrës së bashkpunimit, janë punime drejtëpërsëdrejti në terren të karakterit pyllëzime, zëvendësime dhe shërbime kulturale) e për pasojë duhet domosdoshmërisht të disponojë drejtuesin e vet teknik, për drejtimin dhe menaxhimin teknik të punimeve në terren, që ky operator do të realizojë. Bazuar në argumentat e parashtruara më lart, Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “LURIMI“ sh.p.k & “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k, nuk përmbush kërkesën 2.3.8 të DST (Kapacitetin teknik) për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, në raport me %, që operatori ekonomik “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k, ka marrë përsipër të realizojë në kontratën për bashkimin e përkohshëm të shoqërive (35 %), të datës 31.10.2023, të ngarkuar në systemin elektronik të APP-së, lidhur me këtë procedurë prokurimi. 6. Në kontratën për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, të datës 31.10.2023 midis operatorëve ekonomik “LURIMI“ sh.p.k dhe “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k paraqet disa të meta në raport me kërkesat DST dhe VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Miratimi i rregullave të prokurimit publik“ të ndryshuar, si më posht: - % e pjesmarrjes që secili operator ekonomik merr përsipër të realizojë për ekzekutimin e kësaj kontratë (në rast shpallje fituese) nuk përputhet me kapacitetin ekonomik/financiar dhe teknik që disponon secili operator ekonomik në veçanti në këtë bashkim operatorësh ekonomik, të ngarkuar në systemin elektronik të APP-së, për këtë procedurë prokurimi. - Në kontratën për bashkimin e përkohshëm të shoqërive sipërcituar, nuk specifikohen konkretisht elementët apo zërat e punimeve konkret, që merr përsipër të realizojë secili operator ekonomik në raport me % e fiksuar në këtë kontratë, respektivisht operatori ekonomik “Lurimi” sh.p.k = 65 % dhe operatori ekonomik “DEMA CONSTRUCTION 2014“ sh.p.k = 35 %.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Operatori ekonomik “KURORA” sh.p.k me Nipt J76314803S skualifikohet per arsyet e meposhtme:

Operatori ekonomik “**KURORA**” sh.p.k. ne daten 20.11.2023 ka paraqitur dokumentacionin perkates pasi eshte njoftuar ne SPE, siç parashikohet në pikën 6, të nenit 26, të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Nga verifikimi i bere eshte konstatuar se ne dokumentat e dorezuara ka mungesa, konkretisht si me poshte:

1. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokument qe verteton se ka paguar taksat dhe tarifat vendore per vitin 2023, duke mos permbushur piken 2.2.3: Operatori ekonomik duhet të paraqese një vërtetim që ka paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2023 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB-së).(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqese vërtetimin për taksat dhe tarifat vendore).

2. Operatori ekonomik ka paraqitur per mjetin e kerkuar: - Kontrollin teknik me afat vlefshmerie **27/09/2023**, - Siguracionin me afat vlefshmerie **01/10/2023**, - Taksat vjetore me afat vlefshmerie **20/09/2023**

Procedura eshte zhvilluar ne daten **01/11/2023** dhe rezultojne se dokumentat e paraqitura per mjetin e kerkuar jane jashte afatit e si pasoje nuk jane te vlefshme duke mos permbushur **piken 2.3.6** : Operatori ekonomik duhet te disponojë1 (nje) **automjet të përshtatshëm për transport mallrash** me kapacitet mbajtes minamalisht 3.5 ton per te cilin duhet te paraqese dokumentat e meposhtem:

- **Aktin e pronësisë së mjetit perkatës;**
ose
- **Kontratën noteriale te marrjes me qira të mjetit**, shoqëruar me dokumentacionin perkatës tëpronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi),çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vete ose të trete per ato mjete qe pajisen me leje transporti sipas legjislacionit ne fuqi.

3. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokument qe verteton listepagesat e punonjesve sipas formatit te kerkuar nga legjislacioni ne fuqi duke mos permbushur piken 2.3.7 -: - Nje punësim mesatar prej **17**(shtatëmbëdhjete) personave, per **3 muajt e fundit** të vërtetuar me;

- **Vërtetim të lëshuar nga autoritetet perkatëse,në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;**
- **Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.**

4. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument që verteton disponueshmerinë e drejtuesit teknik me profesion Inxhinier Pyjesh, duke mos permbushur **pikën 2.3.8** : - Operatori duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga Administratori i Shoqërisë, Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i profesionit Inxhinier Pyjesh për të cilin duhet të paraqesë: Kontrata pune, Lejen Profesionale të ushtrimit të profesionit, si dhe të figurorë në listepagesat e shoqërisë për **3 mujorin e fundit**.

5. Tek KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT, pika

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument që verteton se ka paguar detyrimet e energjisë elektrike.

6. Tek KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT, pika

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dëshmi penalteti për administratorin duke mos permbushur kriterin e kërkuar si më sipër.

Oferta juaj s'kualifikohet për arsyet e mësipërme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson

ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: **“PISHA” sh.p.k me Nipt: K12526207V** me adresë: Rruga Labinot fushe Elbasan km 1, zk 2355, pasuria nr.A., se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **10.440.442** (dhjetë milion e katërqind e dyzet mijë e katërqind e dyzet e dy) **lekë (pa tvsh)**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor Bashkia Elbasan me adresë: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë):

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
Zv.Kryetari
Aulona Bylykbashi**